Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Majlinda Bedrolli	**25.10.2023**	**30.10.2023**	**2023/0791**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.10.2023, OE " CAMI KOM " SH.P.K."- Malishevë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0791,kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Agim Morina B.I"-Malishevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "NDERTIMI I RRUGËS PALLANIKU NË FSHATIN BERISHË KK-MALISHEVË - Retender" me nr. të prokurimit: "62500-23-9341-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 25,000.00 €.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Të pa kënaqur me Vendimet e Autoritetit Kontraktues dhe ne pajtim me nenin 109 të LPP-se parashtrojë këtë ankese kundër;

- Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetet Kontraktues te datës 27 shator 2023 (B58) mbi rezultatin e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull te kontratës; Ndërtimi i rrugës Pallaniku në fshatin Berishë, KK. Malishevë për shpërblim te kontratës, ku është rekomanduar **Operatori ekonomik;** Agim Morina B.I, me seli ne Malisheve i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit;16,392.50 euro dhe
- Vendimin për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të datës 4 tetor 2023

Pretendojmë e se Autoriteti Kontraktues përmes Komisionit për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje te dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, *(në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së dhe atë) konkretisht:*

- *Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave*
- *Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi*
- *Neni 71 , Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik*
- *Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

II/ Dispozitat e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.

- Neni , *38, Sqarimi i tenderit,*

Në vazhdim të kësaj ankese do të përpiqemi që të argumentojmë shkeljet e pretenduara të:

1. Të dispozitave të LPP-se në RK dhe atë;

➢ Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar ne kundërshtim me neni 56 , paragrafin 1.1 dhe paragrafi 1.2 te LPP-se ne Republikën e Kosovës.

Ne vijim po citoj dispozitat e nenit 56. paragrafi 1.1 dhe 1.2 te këtij ligji,

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:
1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2. së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kritereve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji.

Marrë parasysh faktin që Autoriteti Kontraktues, është i obliguar qe tenderin ta vlerësoj në pajtim me kriteret për kualifikim dhe përzgjedhje te OE te përcaktuara ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosje te tenderit si dhe bazuar ne Vendimin e AK-se për shpërblim te kontratës te Operatorit Ekonomik" Agim Morina B.I, me seli ne Malisheve i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit prej 16,392.50 euro pretendojmë se Autoriteti kontraktues ka dështuar në kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatoreve ekonomik, konformë kushteve formale administrative të pjesëmarrjes në tender të përcaktuara në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit dhe me këtë rast ka shkel nenin 56 të LPP-së.

➢ ***Neni 59, Vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi ,***

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik; Agim Morina B.I, me seli ne Malisheve i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit prej 16,392.50 euro, është i përgjegjshëm dhe si rrjedhoje e kësaj ka rekomanduar për shpërblim te kontratës me arsyetimin se OE ka ofruar dëshmi dokumentare mbi plotësimin e kërkesave te AK-se te përcaktuara ne paragrafin; III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional te Njoftimit për kontrate dhe paragrafin 9.1&9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, konkretisht ;

Operatori ekonomik i rekomanduar për shpërblim te kontratës nuk ka ofruar dëshmi dokumentare konforme kërkesave te lartë cekura ne Njoftimin për kontrate dhe ne Dosje te tenderit (FDT) dhe nuk është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit.

Të ju përkujtojmë se kërkesat për kualifikim dhe përzgjedhje të OE janë të përcaktuara në Njoftimin për kontrate dhe në FDT të dosjes së tenderit.

Në paragrafin 27 të Informacioneve për tenderuesit te dosjes se tenderit ne mënyrë detale është e parashikuar vlerësimi dhe ekzaminimi, krahasimi i tenderit.

Citoj dispozitat e këtij paragrafi;

27.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Rregulloren për Prokurimin Publik.

27.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

a. *është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;*
b. *është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;*
c. *është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.*

Të qenët "në pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga to dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

Ne Letrën standarde te tenderuesit te eliminuar AK ka arsyetuar vendimin për eliminim nga aktiviteti i prokurimit me arsyetimin se;

Bazuar ne kerkesat e AK-se te percaktuara ne Njoftimin per kontrate dhe ne Dosjen e tednerit shohim se Autoriteti Kontraktues ne Njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit ne paragrafin 9.1 & 9,.2 te Kërkesës se për plotësimin e kapacitetit teknik /profesional ka kërkuar;

Citoj Kërkesën e AK-se;

Kërkesat mbi mundësitë teknike, dhe/ose profesionale paragrafi ; 9.1 & 9.2-Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose Master Drejtimi Konstruktiv, kërkohet te ketë min.3 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimi (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës).

Dëshmia e kërkuar dokumentare;

1.Dëshmi dokumentare, Duhet të posedojë diplomën të ketë kontratën e punës ose para kontratën. 2. OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose Master, Drejtimi, Gjeodezi (jo bachelor), i licencuar me licence valide, kërkohet te ketë min. 2 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës).

Dëshmia e kërkuar dokumentare;

2.Dëshmi Duhet të posedojë diplomën të ketë kontratën e punës ose para kontratën.

3. Kërkesa 3 ,Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Nr. Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve , Sasia e kërkuar **Dëshmi dokumentare**; Sasia që ofron ofertuesi Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionë rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj)

1. Eskavator me peshë minimum 20 t. 1 Copë
2. Eskavator me peshë DERI NE 1.5 tonë . 1 Cope
3. Cekan Hidraulik për minieskavator 1 Cope
4. Lugë ngarkuese. 1 Copë
5. Kamion kiper 1 Copë
6. Kamion kiper me kran 1 Copë
7. Cilindër për ngjeshje të zhavorrit minimum 12 tonë. 1 Copë
8. Cilindër për ngjeshje të zhavorrit me dhëmbëza 1 Copë
9. Instrument gjeodezik GPS për matje dhe rilevim të terrenit 1 Copë

Dëshmia e kërkuar dokumentare;
3.Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira) te mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore për ato automjete qe nuk kane libreza te qarkullimit. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve.

Ne vijim te kësaj kërkese do te argumentojmë pretendimet tona se OE –i rekomanduar për shpërblim te kontratës është i pa përgjegjshëm ne kuptim te dispozitave te LPP-se dhe legjislacionit dytësor te Prokurimit Publik ne Kosovë.

1. **Sqarim lidhur me pretendimin numër 1, se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka përmbushur ne tersi kërkesat e AK-se.**

Bazuar ne kërkesën nr. 2 te FDT-se paragrafi 9.1& 9.2 :

Kërkesa nr.2, OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi (jo bachelor), i liçencuar me licence valide, kërkohet te ketë min. 2 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës) shohim se AK ka kërkuar nga OE te ofrojnë dëshmi dokumentare se kane autorizuar një inxhinjer te diplomuar ose master drejtimi-Gjeodezi (jo bacheler) te licencuar me licence validei cili duhet te këtë se paku 2 vjet përvoje pune-angazhime profesionalë pas diplomimit.

Bazuar ne dëshmitë dokumentare te OE Agim Morina BI lidhur me këtë kërkese i cili ka ofruar një Marrëveshje qiramarrje te mekanizimit e cila është e lidhur me date 12.09.2023 (pas publikimit te njoftimit për kontrate) e lidhur ndërmjet palëve kontraktuese; N.SH "Geo & Metri " dhe N.N "Burimi" e cila përcakton se Qiramarrësi do te i paguaj 50 euro Qiradhënësit për ofrimin e pajisjeve për Matje gjeodezike me te njëjtin Punëtor te Gjeodezisë –Luan Abazin si dhe një dëshmi tjetër (Kontrata e punës për pune specifike) e cila përmban te dhënat mbi posedimin e Licencës valide, CV-ne e Luan Abazit, dhe përvojën e tij te punës, si dhe vendimin mbi nostrifikimin e diplomës nga Ministria e Arsimit Master

Profesional ne Inxhinieri Gjeodezi për Luan Abazin.
Bazuar ne kontratën e tij te punës e cila është e lidhur me date 12 shtator 2023 (ne ditën e hapjes se tenderit) dhe mban titullin Kontrate pune me pune dhe detyra specifike e cila nuk përmban orët e punës ne vit (Ligji i punës lejon maksimizimin 120 dite brenda vitit) si dhe pagën mujore ne vlere prej 200.00 euro, pastaj përmban klauzolën 3 muaj pune provuese (ndërkaq plani dinamik i paraparë për këtë projekt është 25 dite) shohim se OE; Agim Morina BI ka lidh kontrate me te lartpërmendurin pa e nënshkruar kontratën për projektin ne fjale.
Bazuar ne listën e te punësuarve te noterizuar nga Noteri, Zyfer Aliu te datës 04.10.2022 te cilën OE e ka bashkëngjitur ne dosje te tenderit shohim se z. Luan Abazi , me grade Master Profesional ne Inxhinier – i Gjeodezi-së, nuk është përfshirë si anëtar i stafit profesional.
Kërkesa e AK-se është implicite 2.Dëshmi; Duhet të posedojë diplomën të ketë kontratën e punës ose para kontratën.
Si dhe te jete pjese e stafit qe do ta implemntoj projektin ne fjale.
Bazuar ne Listën e stafit, si dhe listën e ATK-se te cilën e ka ofruar OE, për dëshmi dokumentare për Kërkesën nr.2 te paragrafit 9.1& 9.2 qe kane te bëjnë mbi posedimin e kapacitetit teknik/profesional , si dhe bazuar ne dëshmitë e lartë cekura; Marrëveshja për qiramarrje te mekanizmit dhe Kontrata e punës , pretendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me kërkesën e vet te caktuar ne Njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit si dhe me dispozitat e LPP-se dhe si rrjedhojë e kësaj pretendojmë se te gjitha këto dokumentet te prezantuara te cilat janë ne kundërshtim me kërkesën e AK-se, janë fiktive dhe janë te hartuara sa për te përmbushur kinse kërkesën e AK-se dhe kane për qellim qe ta vene ne lajthitje AK
Bazuar ne faktet e lartshënuar pretendojmë se të gjitha këto dëshmi te prezantuara sikur te përmbanin titullin Para kontratë për Marrëveshje për qiramarrje te mekanizmit për matje gjeodezike si dhe Para kontratë për autorizim te angazhimit te një inxhinieri te diplomuar ose Master Drejtimi Gjeodezi (jo bachelor),te i licencuar me licence valide,do te konsideroheshin si ***dëshmi bindëse dokumentare.***

2. **Sqarim lidhur me pretendimin numër 2, se OE i rekomanduar për kontrate nuk ka përmbushur ne tersi kërkesat e AK-se.**

Bazuar ne Kërkesën 3 ,te paragrafit 9.1 & 9.2 te FDT-se,qe ka te beje me posedimin e kapacitetit teknik/profesional, shohim se AK ka kërkuar nga Operatoret Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Nëse i qasemi Listës mbi posedimin e mjeteve ,stabilimenteve dhe pajisjeve teknike te listuar a ne aneksin 7 te FDT-se te cilën e ka ofruar (bashkëngjitur) OE i propozuar për kontrate shohim se:

OE; ka ofruar Listën e makinerisë se rende e cila përmban një logo" Burimi" si dhe në fillim te tekstit përmban te dhënat mbi OE i cili përmban këtë emërtim te OE.
KOMPANNIA PER NDERTIM TRANSORT DHE TREGETI (N.T.T "Burimi")

BURIMI

KOMPANIA PËR NDËRTIM,TRANSPORT DHE TREGTI
Adresa: Rruga Imer Krasniqi 24000 Malishevë - Kosovë
NRB: 80140207, Nr. Fiskal: 600074662, TVSH: 330022400
Xhirollogaria. BPB : 1301001001015206

Telefoni:
044136530,
044450005 / 044749220
Email:
jeminmorina@hotmail.com

Me numër NRB te biznesit 80140207 , ndërkaq ne dëshmitë dokumentare te posedimit te dëshmive profesionale OE: Agim Morina BI ka prezantuar Certifikatën e biznesit me NUI; 810703571 Agim Morina BI, emri tregtar N.N.T "Burimi" .

Lista e makinerisë se rëndë përmban regjistrin e mjeteve prej numrit rendor 1 deri ne 56 ndërkaq ne ketë liste ka hijezuar me ngjyre te verdhe makineritë prej numrit rendor 24-34 .

1. **Lidhur me kërkesën nr 1 te aneksit 7 , Eskavator me peshë minimum 20 t. 1 Copë** OE i propozuar për kontratë ka ofruar dëshmi dokumentare; Një fature tatimore te datës 10.12.2020 te blere nga " Buli Com" ne vlere prej 1,534.00 euro, e cila nuk përmban Librezën e qarkullimit .
2. **Lidhur me kërkesën nr. 2 Eskavator me peshë DERI NE 1.5 tonë .1** Cope ,

Boduzher Raup cat D4 ka ofruar vetëm një fature tatimore te datës 10.12.2020 te blere nga Agim Morina BI, ndërkaq nuk ka ofruar dëshmi mbi Librezën e qarkullimit.

OE ka ofruar një fature tjetër nga NN"Shala" Mini eskavator i përdorur te blere ne vitin 2017 ne vlere prej 3,500.00 euro e cila nuk përmban Librezën e qarkullimit,si dhe disa foto për korpë dhe Çekan.

3. **Lidhur me kërkesën numër 3. Çekan Hidraulik për mini-eskavator,1 Cope,** OE ka ofruar vetëm disa foto por nuk ka ofruar dëshmi dokumentare konform kërkesës se AK-se.

Librezën e qarkullimit për Kamion Kiper me dy dyer me traga 04-253-IE i cili është i regjistruar dhe ka validitet deri me 03.09.2023 ne emër te Agim Morina BI,

4. **Lidhur me kërkesën numër 4 , Lugë ngarkuese,1 Copë**, OE, ka ofruar një kopje te kontratës mbi shitblerjen e pajisjes, faturën dhe Dudin Doganor, por nuk ka ofruar Librezën e qarkullimit

5. Lidhur me kërkesën nr.5; **një Kamion Kiper me dy dyer** 1 copë, Operatori ekonomik ka ofruar dëshmi Librezën e qarkullimit me targa 04-549-JT i cili ka pasur regjistrim valid deri me date 19.06.2024.

6. **Kamion kiper me kran,1 Copë,** OE ka ofruar dëshmi, Librezën e qarkullimit ne pronësi te Bageri Companise me targa 05-795-FL e cila nuk është ne pronësi te OE, dhe nuk ka ofruar dëshmi dokumentare mbi marrjen me qira.

7.**Lidhur me kërkesën nr 7. Cilindër për ngjeshje të zhavorrit minimum 12 tonë.1 Copë,** OE ka ofruar një fature te datës 27.05.2022 me titull Vobrator qe montohet ne ekskavator , i përdoruar te blere nga N.SH" Shala" ne vlere prej 200, 00 euro.

8. **Lidhur me kërkesën nr 8, Cilindër për ngjeshje të zhavorrit me dhëmbëza, 1 Copë, OE nuk ka ofruar dëshmi dokumentare.**

9. **Lidhur me kërkesën nr 9**, Instrument gjeodezik GPS për matje dhe rilevim të terenit,1 Copë, OE ka ofruar dëshmi një Marrëveshje te marrjes me qira me OE; N.SH "Geo&Metri ku qiradhënës është Luan Abazi i cili njëkohësisht ne këtë dosje te tenderit është prezantuar si Gjeodet i kontraktuar ne cilësi te Punëtorit Gjeodet.

Bazuar ne dëshmitë dokumentare te dorëzuara nga OE: Agim Morina B.I te cilat i ka bashkëngjitur tenderit te tij për aktivitetin e prokurimit me titull te kontratës; NDERTIMI I RRUGËS PALLANIKU NË FSHATIN BERISHË KK-MALISHEVË-Ri tender, si dhe bazuar ne kërkesat e AK te përcaktuara ne paragrafin 9.1&9.2 te Dosje se tenderit dhe Njoftimit për kontrate, pretendojmë se AK ka bere shkelje te dispozitave te nenit 59 te LPP-se duke shpërblyer me kontrate operatorin ekonomik i cili është i pa përgjegjshëm ne kuptim te kushteve për kualifikim dhe pjesëmarrje ne tender.

- *Neni 71 , Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik*

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 71 te LPP-se në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik; Agim Morina B.I, me seli ne Malisheve, është i përgjegjshëm duke marrë parasysh faktin qe i ka mundësuar anëtarit-Liderit te Grupit te OE: "Burimi AAF" shpk& "Adea Construktion " qe ne dosjen e tij te tenderit te i ofroj dëshmi dokumentare mbi posedimin e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht listën e pajisjeve te mjeteve te punës te cilat janë prone e NNT "Burimi" me emër tregtar te tij.

Bazuar ne Procesverbalin e hapjes shohim se ne këtë tender ka marre pjese edhe një OE i cili tenderin e ka dorëzuar ne emër te Grupit te Operatorëve Ekonomik" BURIMI" AAF" SH.P.K.& "ADEA CONSTRUKTION", i cili ka ofertuar me çmim me vlerë totale të tenderit prej 24,370.00 Euro;

Lideri i Grupit "Burimi AAF" sh.p.k, i cili posedon numrin unik te biznesit 811918385,i cili përfaqësohet nga Alban Morina ka nënshkruar Deklaratën ai nuk merr pjese ne te njëjtat procedura te prokurimit .

Bazuar ne faktet e lartshënuara pretendojmë se OE; Burimi AAF shpk, ne cilësi te anëtarit te grupit te OE me rastin e nënshkrimit te Deklaratës mbi themelimin e grupit te operatoreve ekonomik ka bere shkelje te dispozitave te nenit 71 paragrafi 2 i cili shprehimisht përcakton me sa vijon;

2. Nëse një tender dorëzohet nga një grup i tillë, grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.

Bazuar ne faktet e lartpërmendura pretendojmë se Komisioni për vlerësimin e tenderit ka bere shkelje te dispozitave te nenit 71 te LPP-se.

- *Neni 72, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij në ligji në momentin kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik; Agim Morina B.I, me seli ne Malisheve i cili ka ofertuar me çmimin total te tenderit;16,392.50 euro është i përgjegjshëm ne momentin kur nuk ka aplikuar nenin 72 te LPP-se i cili përcakton me sa vijon:

ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Bazuar në dosjen e tenderit si dhe sistemin e –prokurimit shihet qarte se AK –se, nuk ka aplikuar nenin 72 te LPP-se dhe si rrjedhoje e kësaj ka bere shkelje te dispozitave te nenit 72.2 te LPP-se.

II/ Dispozitat e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik te datës 01.11.2022.

- **Neni 26, Grup i Operatorëve Ekonomik**

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 26.1 , shkronja b, dhe 26.11 te Rregullores për Prokurimin Publik e cila përcakton rregullat lidhur me pjesëmarrjen e grupit si tersi dhe pjesëmarrjen individuale te OE ne te njëjtën procedure te prokurimit (Rregullores Nr.001/2022) kur ka vlerësuar se tenderi i operatorit ekonomik; Agim Morina B.I, me seli ne Malisheve, është i përgjegjshëm duke marrë parasysh faktin qe ai ka deklaruar se nuk merr pjese individualisht ne procedurën e njëjtë te prokurimit.
Ne te vërtet ai i ka mundësuar, anëtarit-Liderit te Grupit te OE: "Burimi AAF" shpk& "Adea Construktion " qe në dosjen e tij te tenderit të i ofroj dëshmi dokumentare lidhur me mbi posedimin e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht listën e pajisjeve te mjeteve te punës (Lista e makinerisë) te cilat janë prone e NNT "Burimi" me emër tregtar te tij.

Në vijim po citoj disa paragrafë te nenit 26 të Rregullores;

26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet te:
a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për përformancën e kontratës;
b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);
26.11 OE-të nuk lejohen të prezantojnë një tender si individual dhe si anëtarë të një grupi në të njëjtën kohë në një aktivitet të prokurimit. Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet.....?

- Neni 38, Sqarimi i tenderëve,

Pretendojmë se Komisioni për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e

tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 38.3 te Rregullores për Prokurimin Publik.

Neni 38.3 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik ne mënyrë te qarte përcakton rastet se kur Autoriteti kontraktues duhet të kërkoj ndonjë informacion apo dokumente te cilat i mungojnë OE ne dosjen e tij te tenderit.

Duke u bazuar ne nenin 38.3 te Rregullores i cili shprehimisht përcakton se këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate, i cili ne rastin konkret Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-se që ndërlidhet me nenin 38 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik.

Citoj dispozitën e nenit 38.3 te Rregullores.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.
Bazuar ne procedurën e rivlerësimit ne nuk kemi vërejtur se ne e-prokurimin të Autoritetit kontraktues është shfrytëzuar ky obligim ligjor që para marrjes së Vendimit për eliminim ose për shpërblim te kontratës të beje Kërkesë për Sqarim të tenderit (menyja Sqarimet e tenderit).

Bazuar në dosjen e tenderit si dhe sistemin e –prokurimit shihet qarte se AK –se, nuk ka aplikuar nenin 38 te Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik se dhe si rrjedhoje e kësaj ka bere shkelje te dispozitave te nenit 38.3 te Rre.

Duke pasur parasysh këto fakte kërkojmë nga Paneli i OSHP-së që pas administrimit të provave dhe fakteve të nxjerr :

VENDIM

- **T' APROVOJ**, Ankesën e OE: CAMI KOM SH.P.K me seli në Malisheve si të bazuar,

- **T' ANULOJ**, Njoftimin mbi Vendimin e AK-se të datës 12.05.2023, mbi rezultatin e tenderit ku është propozuar për shpërblim te kontratës, OE: Agim Morina B.I " me seli ne në Malisheve, ne vlere prej; 16,392.50 euro.
- **TE KTHEJ TENDERIN NE RIVLERESIM**, dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me kriteret për dhënie kontratës dhe kriteret e përzgjedhjes te cilat janë te përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në FDT të dosjes së tenderit, LPP-ne, Rregulloren për Prokurimin Publik Nr.001/2022 dhe Udhëzuesin për Prokurim Publik Nr.001/2023.

Mbetemi me shpresë se ankesa e jone do të shqyrtohet pozitivisht.
Me nderime,
Lulzim Berisha
Drejtor
CAMI KOM SH.P.K."
Malishevë

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional:

2. OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi (jo bachelor), i liçencuar me licence valide, kërkohet te ketë min. 2 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës).	**2.Dëshmi Duhet të posedojë diplomen të ketë kontratën e punës ose parakontraten.**
3. Kërkesa. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.	**3.Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira) te mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore per ato automjete qe nuk kane libreza te qarkullimit.Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve.**

ANEKSI - LISTA E PAISJEVE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj)
1.	Eskavator me peshë minimum 20 t.	1 Copë		
2.	Eskavator me peshë DERI NE 1.5 tonë .	1 Cope		
3.	Cekan Hidraulik per minieskavator	1 Cope		
4.	Lugë ngarkuese.	1 Copë		
5.	Kamion kiper	1 Copë		
6.	Kamion kipper me kran	1 Copë		
7.	Cilinder për ngjeshje të zhavorit minimum 12 tonë.	1 Copë		
8.	Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza	1 Copë		
9.	Instrument gjeodezik gps për matje dhe rilevim të terenit	1 Copë		
10.	Greder.	1 Copë		

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: NDERTIMI I RRUGES PALLANIKU NË FSHATIN BERISHË KK-MALISHEVE - Retender

Numri i aktivitetit te prokurimit:

Nr. i Prokurimit:	62500	2	3	9	3	4	1	5	2	1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	" CAMI KOM " SH.P.K. MALISHEVË 24000 MALISHEVË	17957.00€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik BURIMI AAF SH.P.K.; ADEA CONSTRUCTION SH.P.K. Rr.Skenderbeu pn Malisheve 24000 Malisheve	24370.00€
3.	Agim Morina B.I. Imer Krasniqi 20400 MALISHEVË	16392.50€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Kuvendi i Komunës Malishevë shpërblen me kontratë : Agim Morina B.I., Imer Krasniqi, 20400, MALISHEVË në vlerë totale të ofertës : 16392.50€

Data: 27.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP:

Nuhi Shalaj

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" CAMI KOM " SH.P.K.**

Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Malisheve, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar e kontratës 25,000.00 €. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës, ndërsa AK – Kuvendi Komunal Malisheve me datë 27.09.2023, ka njoftuar OE ankues "Cami Kom" SH.P.K-Malisheve përmes Letra standarde si tenderues i pasuksesshëm.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, kundrejt pretendimeve ankimore të OE ankues "Cami Kom" SH.P.K-Malisheve, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 56, 59, 71 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenin 26 dhe 38 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë "Agim Morina B.I"-Malishevë, nuk ka plotësuar kërkesat tek pika 9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional, përkatësisht kërkesën nr. 2 dhe 3 të DT, për kërkesën numër 2 OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Marrëveshje qiramarrje te mekanizmit e cila është e lidhur me datën 12.09.2023 është (pas datës se publikimit të njoftimit për kontrate) e lidhur ndërmjet palëve kontraktues N.SH "Geo& Metri" dhe N.N "Burimi" e cila përcakton se qiradhënësi do të paguaj 50 euro qiradhënësit për ofrimin e pajisjeve për Matje gjeodezike me të njëjtin punëtor të gjeodezisë- Luan Abazi, tutje OE ankues shton se OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi tjetër ka bashkangjitur (Kontrata për pune specifike) e cila përmban të dhëna mbi posedimin e Licencës valide ,CV e Luan Abazit dhe përvojën e tij të punës diplomën etj...

OE ankues pretendon se kontrata është e lidhur me datën 12 shtator 2023 (në ditën e hapjes se tenderëve), kjo kontratë nuk përbën orët e punës në vit (Ligjit i punës lejon maksimizimin 120 dite brenda vitit) si dhe pagën mujore në vlerë prej 200.00 euro, pastaj përmban klauzolën 3 muaj pune provues (ndërkaq plani dinamik i paraparë për këtë projekt është 25 dite), OE i rekomanduar për kontratë lidh kontratën pa nënshkruar kontratën në fjalë dhe inxhinieri Luan Abazi bazuar në listën e të punësuarve nuk është i përfshirë si anëtar i stafit profesional të OE të rekomanduar për kontratë. Tutje, OE ankues pretendon se te gjitha këto dokumente të

prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë fiktive dhe janë hartuar sa për të përmbushur kinse kërkesën e AK-së dhe kanë për qellim ta venë në lajthitje AK-në. OE ankues shton se te gjitha këto dëshmi si para kontrata për marrëveshje për qira marrjen e mekanizmit për matje gjeodezike si dhe par kontrata për autorizim te angazhimit te inxhinierit nuk do mirën parasysh dhe janë dëshmi bindëse.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat 9.1&9.2 (2 dhe 3) Kapaciteti teknik dhe profesional: AK ka kërkuar:

2. OE duhet te dëshmoj se ka autorizuar një inxhinier te diplomuar ose master Drejtimi Gjeodezi (jo bachelor), i licencuar me licence valide, kërkohet te ketë min. 2 vite përvojë pune – angazhime profesionale pas diplomimit. (Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës).	2.Dëshmi Duhet të posedojë diplomen të ketë kontratën e punës ose parakontraten.
3. Kërkesa. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.	3.Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira) te mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore per ato automjete qe nuk kane libreza te qarkullimit.Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve.

Bazuar në shkresat e lëndës, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë lidhur me kërkesën nr. 2 ka dorëzuar me tender dokumentet si: Dokumentin me titull "7.Ing Gjeodezise.rar" dhe "10.marrveshja për Paisje gjeodezike.pdf**". Ekspertja shqyrtuese** sqaron se pretendimi i OE ankues është i pa qëndrueshëm për faktin se inxhinieri në fjalë ka kualifikimin shkollor sipas kërkesës se AK-së, posedon licence valide, ka të bashkangjitur cv dhe referencat të cilat dëshmojnë përvojën e punës sipas kërkesë së AK. Për të njëjtin është bashkangjitur edhe Kontrata e punës për punë dhe detyra specifike për këtë projekt, kjo kontratë është e nënshkruar në mes të punëdhënësit dhe të punësuarit, që plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Sa i përket pretendimit të OE ankues se kontrata është nënshkruar me datën **12.09.2023** apo para njoftimit për kontratë (në ditën e hapjes së tenderëve), **Ekspertja**

shqyrtuese sqaron se vetëm kërkesat si dëshmitë për përfundimin me sukses të kontratave të natyrës të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) dhe qarkullimi financiar/vjetor lidhen me datën e njoftimit për kontratë. Ndërsa marrëveshjet për huazimin e mjeteve të punës, para kontrata apo kontrata me punëtor apo blerje të pajisjeve dhe çdo kërkesë tjetër mund të lidhet deri në orën e fundit të afatit për dorëzimin e tenderit, që do të thotë se në këtë rast, hapja e tenderëve ka qenë me datë **12.09.2023** në ora **14:30h,** rrjedhimisht çdo operator ekonomik ka mundur që të lidhë marrëveshje apo kontrata me inxhinier apo staf tjetër varësisht nga kërkesat e përcaktuar në DT deri me këtë datë **12.09.2023 para orës 14:30h**.

Sa i përket pretendimit të ankuesit lidhur me përmbajtjen e kontratës në mes inxhinierit dhe OE të rekomanduar për kontratë, si orari, paga dhe dyshimet e ankuesit se kontrata mund jetë fiktive dhe janë hartuar sa për të përmbushur kërkesën e AK-së dhe ka për qellim ta venë në lajthitje AK-në, etj., **Ekspertja shqyrtuese sqaron** se ky pretendim ankimor është paragjykues sepse nuk ka të bëjë me çështje në të cilën mund të japim përgjigje, pasi që vlerësimi jonë duhet të bazohet në prova shkresore dhe argumente për secilën përgjigje që japim, kurrsesi të japim vlerësime për dyshime të cilat i ngrit një OE dhe nuk argumenton me dëshmi. Sa i përket pikës ankimore që ka të bëjë me kontratën për pagë, orar të punës, etj., ekspertja shqyrtuese nuk konsideron se kontrata e lidhur mes dy palëve është çështje kontraktuale mes palëve dhe nuk mund të kontestoj obligimet kontraktuale të palëve.

Sa i përket pikës tjetër ankimore se inxhinieri Luan Abazi bazuar në listën e të punësuarve nuk është i përfshirë si anëtar i stafit profesional, ekspertja shqyrtuese konsideron se edhe kjo pikë është e pa bazuar sepse kërkesa e AK ka mundësuar që për inxhinier të dëshmohet se kanë kontrata ose para kontratë për këtë projekt e jo ti kenë të punësuar siç pretendon ankuesi. Andaj, duke pasur parasysh nenin 56.3 të LPP-së, është e ndaluar që të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura tenderuesi në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në kuptim te kësaj dispozite dhe provave te prezantuara, pretendimi i ankuesit është **i pa bazuar**

<u>Provë: Shkëputje e një pjese të Procesverbali të hapjes se tenderëve dhe të Kontratës me inxhinierin e Gjeodezist.</u>

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	62500-23-9341-5-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	NDERTIMI I RRUGËS PALLANIKU NË FSHATIN BERISHË KK-MALISHEVË - Retender
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
12.09.2023	12.09.2023, 14:30:00	12.09.2023, 14:30:00	ZYRA E PROKURIMIT NR.32 KATI I II KK-MALISHEVË E-PROKURIM.	3

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
			NDERTIMI I	PO	15317.70		

Në përputhje me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.3, dhe nenin 11 paragrafi 1, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më dt. 01.12.2010,Punëdhënësi dhe Punëmarrësi, si subjekte të marrëdhënies juridike të punës, lidhin këtë:

KONTRATË PUNE
PËR PUNË DHE DETYRA SPECIFIKE
Neni 1

NTT ,, BURIMI ,, Malisheve. adresa: Rr. Imer Krasniqi pnr, Malisheve

me Nr.Biznesi 801703571 me Nr.Fiskal 600074562
(emri/emërtimi, selia, adresa dhe numri i regjistrimit të biznesit punëdhënësit)
të cilin e përfaqëson:Agim Morina (në tekstin e mëtejshëm: Punëdhënësi),
lidhe kontratë pune me: Luan Abazi i lindur më 24.01.1989 ne Mushtisht K.K. Suhareke.
(emri dhe mbiemri i të punësuarit, kualifikimi dhe adresa e të punësuarit (në tekstin mëtejshëm: i punësuari).

Neni 2

I punësuari do të kryej këto detyra të punës: Punet Gjeodezike
(emërtimi, natyra,lloji i punës dhe përshkrimi i detyrave të punës)

Neni 3

I punësuari do të kryej punët në: Projektin e mundshem per projektin;

NDERTIMI I RRUGËS PALLANIKU NË FSHATIN BERISHË KK-MALISHEVË - Retender
Nr. Prok-62500-23-9341-5-2-1

(vendi i punës ku do të kryhet puna, si dhe njoftimi që puna do të kryhet në lokacione të ndryeshme).

Neni 4

I punësuari themelon marrëdhënie pune, në: 12.09.2023
1) kohë të caktuar, duke filluar nga: 12.09.2023 deri ne perfundimin e projektit
(data e fillimi dhe mbarimit të punës).

Neni 5

Neni 24

Pas njoftimit me pëmbajtjën e Kontratës, kjo Kontratë nga palët kontraktuese u nënshkrua me datën: 12.09.2023, në: Malisheve, në: 4 kopje autentike, nga të cilat, secilës palë i mbetën nga dy kopje.
(vendi)

Punëdhënësi
Agim Morina

I/e punësuari
Luan Abazi

Vv

Lidhur me pretendim e dytë të operatorit ekonomik ankues, i cili pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e 3 tek Kapaciteti teknik dhe profesional, pasi që disa nga mjetet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, nuk kanë të bashkangjitur libreza të qarkullimit dhe për disa mjete nuk është bashkangjitur dëshmi dokumentare marrja me qira sipas ankuesit. Tutje, OE ankues pretendon se AK ka shkelur 59 dhe 71 të LPP-së, kur ka rekomanduar ketë operator ekonomik për kontratë pasi që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Agim Morina BI i ka mundësuar anëtarit të liderit të grupit të operatorit ekonomik "NNT Burimii AAF sh.p.k & Adea Construktion" që në dosjen e tenderit të tij që ti ofroj dëshmi dokumentare listën e pajisjeve të mjeteve të punës, të cilat janë pronë e OE NNT "Burimi" me emër tregtar të tij. Me tej, OE ankues shton se bazuar në procesverbalin e hapjes së ofertave shohim se ka marr pjesë edhe një OE i cili tenderin e ka dorëzuar në emër të grupit të operatoreve ekonomik "BURIMI" AAF sh.p.k & "ADEA CONSTRUKTION" i cili ka ofertuar me çmim me vlerë totale të tenderit prej 24,370.00 euro. Lideri i grupit "BURIMI" AAF sh.p.k i cili posedon numrin unik të biznesit 811918385 i cili përfaqësohet nga Alban Morina ka nënshkruar deklaratën se si nuk merr pjesë në të njëjtat procedura te prokurimit. Ankuesi pretendon se "BURIMI" AAF sh.p.k ka bërë shkelje të dispozitave të nenit 71 par. 2 të LPP-së. Tutje, OE ankues shton se me këtë rast është shkelur edhe nenin 26 tëRREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, neni 59, 71 dhe 72 i LPP-së.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK ka kërkuar:3. Kërkesa. *"Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT."*

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

*"3.**Dëshmi mbi pronësinë (apo marrëveshje te marrjes me qira)** te mjeteve, librezat e qarkullimit dhe Deklaratat unike doganore për ato automjete qe nuk kane libreza te qarkullimit.Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë **duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve."***

ANEKSI - LISTA E PAISJEVE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona rexh. i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj)
1.	Eskavator me peshë minimum 20 t.	1 Copë		
2.	Eskavator me peshë DERI NE 1.5 tonë .	1 Cope		
3.	Cekan Hidraulik per minieskavator	1 Cope		
4.	Lugë ngarkuese.	1 Copë		
5.	Kamion kiper	1 Copë		
6.	Kamion kipper me kran	1 Copë		
7.	Cilinder për ngjeshje të zhavorit minimum 12 tonë.	1 Copë		
8.	Cilinder për ngjeshje të zhavorit me dhëmbëza	1 Copë		
9.	Instrument gjeodezik gps për matje dhe rilevim të terenit	1 Copë		
10.	Greder.	1 Copë		

Bazuar në shkresat e lëndës dhe në ofertën e Operatori ekonomik të rekomanduar për kontratë, lidhur me kërkesën nr. 3, i njëjti me tender ka dorëzuar dokumentet si:***8.Makineria Burimi - 1.rar*10.marrveshja per Paisje gjeodezike.pdf,*11.Minieskavator ,Min 1.5.rar,12.Marrveshje kamion me kran.rar***







Për të dhënë sqarime sa më të qarta lidhur me ketë pretendim, **ekspertja shqyrtuese** ju ka drejtuar zyrës se prokurim me datë 30.10.23 përmes emalit zyrtar, duke kërkuar që të ofrojnë dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë i posedon këto pajisje sipas kërkesë së AK-së. Me datë 31.10.2023 kam pranuar përgjigje lidhur me secilën pajisje të cilën e ka kontestuar ankuesi, në po të njëjtën shkresë është verifikuar se cilat dëshmi ka sjell OE i rekomanduar për kontratë dhe jepen sqarime për secilin mjet. Në bazë të këtij sqarimi të AK-së**, ekspertja** konsideron se është në kompetencë të autoritetit kontraktues, konkretisht komisionit të vlerësimit të ofertave dhe zyrtarit përgjegjës të prokurimit se këto pajisje janë sipas kërkesë së

kërkuar pasi të njëjtit në mënyrë të detajuar kanë dhënë sqarime për secilën pajisje të kontestuar. Andaj pretendimi ankimor është i **pa bazuar.**

Sa i përket pretendim tjetër të ankuesit se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Agim Morina BI, i ka mundësuar liderit të grupit të operatorit ekonomik "NNT Burimii AAF sh.p.k & Adea Construktion" që në dosjen e tenderit të tij t'i ofroj dëshmi dokumentare listën e pajisjeve të mjeteve të punës, të cilat janë pronë e OE NNT "Burimi" me emër tregtar të tij, etj... **Ekspertja shqyrtuese** sqaron segrupi i OE"NNT Burimii AAF sh.p.k & Adea Construktion" ka qenë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, i cili sipas letrës standarde të 27.09.2023 është eliminuar, i njëjti nuk ka parashtruar ankesë në Oshp. Po ashtu sqarojmë se bazuar në pretendimin e ankuesit, se i njëjti ka marr pjesë me pajisje të njëjta, **ekspertja shqyrtues** sqaron se bazuar në ofertën e këtij operatori ekonomik, nuk kam has në listën e OE Burimi me pajisje të njëjta siç pretendon ankuesi. OE"NNT Burimii AAF" sh.p.k ka ofruar Marrëveshje për listë të pajisjeve me OE N.N.SH Word Medium mirëpo nuk kemi hasur në pajisje të njëjta siç pretendon OE ankues andaj pretendim është i pa bazuar. Sa i përket pretendimit ankimor, se i njëjti ka marr pjesë në të njëjtën procedurë të prokurimit dhe është bërë shkelje e nenit 71 par. 2 dhe 72 të LPP-së, si dhe nenit 26 dhe 38 të rregullores nr.001/2022 për prokurim publik, **ekspertja shqyrtues** sqaron se kemi kërkuar në faqen zyrtare të ARBK-së për këto dy biznese dhe rezulton se këto dy biznese kanë numër të ndryshëm të numrit unik identifikues dhe kanë pronar të ndryshëm, po ashtu në listën e pajisjeve për të cilën pretendon OE ankues e kanë të ndryshme. Ankuesi në pretendim cek që lista e pajisjeve të dorëzuara nga "NNT Burimi AAF" sh.p.k janë pronë e OE të rekomanduar "Agim Morina" BI me emër tregtar N.N.T. "Burimi", kurse pas shqyrtimit të pajisjeve të OE "NNT Burimi AAF" sh.p.k, rezulton se pothuajse të gjitha pajisjet i ka huazuar nga OE N.N.SH. "Word Medium", ku për më tepër është bashkangjitur lista e pajisjeve me titull "5.Marrveshja për pasije - WORD MEDIUM.rar", ku në këtë dokument janë 52 pajisje të huazuara nga N.N.SH. "Word Medium". Andaj pretendim është i pa bazuar.

<u>Provë: Kërkesa për sqarime drejtuar AK-së dt: 30.10.2023</u>

Reply Reply All Forward

Prokurimi Malisheve Majlinda Bedrolli 1 9:52 A

Sqarim per paisje.

Retention Policy DelFiveYOldEm (5 years) Expires 10/29/2028

You replied to this message on 10/31/2023 10:00 AM.

DOK.SQARIM PËR OSHP.docx
19 KB

Pershendetje e nderuara eksperte shqyertuese ne attach. e gjeni sqarimin per paisje. Ju falemenderit per mirkuptim.

From: Majlinda Bedrolli
Sent: Monday, October 30, 2023 1:37 PM
To: Prokurimi Malisheve
Cc: OSHP
Subject: Kërkesë per dëshmi të paisjeve!

Të nderuar,

Sipas autorizimit me nr.791/23, jam duke e shqyrtuar ankesën e operatoreve ekonomik OE Cami Kom sh.p.k , qe ka të beje me Aktivitetin e Prokurimit me titull "NDERTIMI I RRUGËS PALLANIKU NË FSHATIN BERISHË KK-MALISHEVË – Retender" nr. i prokurimit 62500-23-9341-5-2-1 - Autoriteti Kontraktues-Kuvendi Komunal Malisheve, që të jemi sa më objektiv në shqyrtimin e kësaj lënde, na nevojitet sqarim nga ana e juaj pasi qe në kërkesën për rishqyrtim nuk kemi hasur ne përgjigje nga ana juaj si autoritet kontraktues !

Andaj sipas nenit 114, par. 1 të LPP-së, kërkoj që të më siguroni dhe të më bashkëngjitni dëshmi lidhur me listën e pajisjeve të cilat i konteston ankuesi.

Ju lutem na sqaroni dhe të na bashkëngjitni dëshmi lidhur me listën e pajisjeve të cilat i konteston ankuesi.

1. **Lidhur me kërkesën nr 1 te aneksit 7 , Eskavator me peshë minimum 20 t. 1 Copë** OE i propozuar për kontratë ka ofruar dëshmi dokumentare; Një fature tatimore te datës 10.12.2020 te blere nga " Buli Com" ne vlere prej 1,534.00 euro, e cila nuk përmban Librezën e qarkullimit .
2. **Lidhur me kërkesën nr. 2 Eskavator me peshë DERI NE 1.5 tonë .1 Cope .**

Boduzher Raup cat D4 ka ofruar vetëm një fature tatimore te datës 10.12.2020 te blere nga Agim Morina BI, ndërkaq nuk ka ofruar dëshmi mbi Librezën e qarkullimit.
OE ka ofruar një fature tjetër nga NN"Shala" Mini eskavator i përdorur te blere ne vitin 2017 ne vlere prej 3,500.00 euro e cila nuk përmban Librezën e qarkullimit,si dhe disa foto për korpë dhe Çekan.

3. **Lidhur me kërkesën numër 3. Çekan Hidraulik për mini-eskavator,1 Cope,** OE ka ofruar vetëm disa foto por nuk ka ofruar dëshmi dokumentare konform kërkesës se AK-se.

Librezën e qarkullimit për Kamion Kiper me dy dyer me traga 04-253-IE i cili është i regjistruar dhe ka validitet deri me 03.09.2023 ne emër te Agim Morina BI,

4. **Lidhur me kërkesën numër 4 , Lugë ngarkuese,1 Copë**, OE, ka ofruar një kopje te kontratës mbi shitblerjen e pajisjes, faturën dhe Dudin Doganor, por nuk ka ofruar Librezën e qarkullimit
5. Lidhur me kërkesën nr.5: **një Kamion Kiper me dy dyer** 1 copë, Operatori ekonomik ka ofruar dëshmi Librezën e qarkullimit me targa 04-549-JT i cili ka pasur regjistrim valid deri me date 19.06.2024.
6. **Kamion kiper me kran,1 Copë**, OE ka ofruar dëshmi, Librezën e qarkullimit ne pronësi te Bageri Companise me targa 05-795-FL e cila nuk është ne pronësi te OE, dhe nuk ka ofruar dëshmi dokumentare mbi marrjen me qira.
7. **Lidhur me kërkesën nr 7. Cilindër për ngjeshje të zhavorrit minimum 12 tonë.1 Copë.** OE ka ofruar një fature te datës 27.06.2022 me

7. **Lidhur me kërkesën nr 7. Cilindër për ngjeshje të zhavorrit minimum 12 tonë.1 Copë,** OE ka ofruar një fature te datës 27.05.2022 me titull Vobrator qe montohet ne ekskavator , i përdoruar te blere nga N.SH" Shala" ne vlere prej 200, 00 euro.

8. **Lidhur me kërkesën nr 8, Cilindër për ngjeshje të zhavorrit me dhëmbëza, 1 Copë, OE nuk ka ofruar dëshmi dokumentare.**
9. **Lidhur me kërkesën nr 9.** Instrument gjeodezik GPS për matje dhe rilevim të terenit,1 Copë, OE ka ofruar dëshmi një Marrëveshje te marrjes me qira me OE; N.SH "Geo&Metri ku qiradhënës është Luan Abazi i cili njëkohësisht ne këtë dosje te tenderit është prezantuar si Gjeodet i kontraktuar ne cilësi te Punëtorit Gjeodet.

Duke pasur parasysh që me rastin e paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomik, ne si Organ Shqyrtues jemi të obliguar që ti respektojmë afatet ligjore, ju lusim që sa më shpejt që të jetë e mundur të na ti përcjellin te gjitha dëshmitë lidhur me mjete e kontestuar në ankesë.

Ju lutemi te na e konfirmoni pranimin e e-mailit.

Me respekt,

<u>Provë: Sqarim nga zyra e prokurimit sipas kërkesë së lart përmendura</u>

SQARIM

Lidhur me projektin : **NDERTIMI I RRUGËS PLLANIKU NE FSHATIN BERSHË KK MALISHEVE – Ritender me Nr.Prok : 62500-23-9341-521.**

Pika 1. Eskavator me peshe minimum 20t cope 1. OE i propozuar per kontrate ka ofruar deshmi dokumentare , nje fatur tatimore te dates 10.12.2020 te blere nga BULI COM me vlere 1534.00€ e cila nuk permban libreze te qarkullimit.

Pika 1- Në FOLDERIN NR. 9 te dosjes se tenderit gjenden eskavatoret të cilët i plotsojn kushtet e kerkuara ne FDT te dosjes se tenderit si psh. LIEBEHERR 934 ,LIEBHERR 932 etj te cilet gjenden edhe ne listen e Paisjeve. Sqarim ky lloj I paisjeve nuk posedon libreze të qarkullimit pasi qe këto paisje nuk qarkullojn në rrugë , ato punojn dhe veprojn vetem ne vendepunishte, si dhe sqarojmë se fatura nga BULI COM me vlere 1534.00 nuk i përket eskavatorit por i përket BULDUZHER D4.

Pika 2. Lidhur me kerkesen nr.2 , eskavator me peshe deri 1.5t cope 1.

Pika 2 – Lidhur me Piken 2 ne dosjen e tenderit ne FOLDERIN 11 te dosjes gjenden deshmij (Fatura dhe DUD) I blere nga NSH SHALA , Sqarim ky lloj I paisjeve nuk posedon libreze të qarkullimit pasi qe këto paisje nuk qarkullojn në rrugë , ato punojn dhe veprojn vetem ne vendepunishte I njejti sqarim vlene edhe për Paisjen Bulduzher D4.

Pika 3. Lidhur me kerkesen numer 3 ?ekan Hidraulik per minieskavator cope 1. OE ka ofruar vetem disa foto por nuk ka ofruar deshmi dokumentare konform kerkeses se AK-se.

Pika 3. – Ne dosjen e tenderit FOLDER NR 9 – paisjet gjendet Fatura e blerjes me NR. 002917 nga NSH SHALA .

Pika 4. -Lidhur me kerkesen nr.4 ,Luge ngarkuese cope 1 , OE ka ofruar një kopje te kontrates mbi shitblerjen e paisjes ,faturen dhe dudin ,por nuk ka ofruar librezen e qarkullimit.

Pika 4 -Sqarim ky lloj I paisjeve nuk posedon libreze të qarkullimit pasi qe këto paisje nuk qarkullojn në rrugë , ato punojn dhe veprojn vetem ne vendepunishte.

Pika 5. Lidhur me kerkesen nr 5 ,nje kamion kiper dy dyer cope 1 ,OE ka ofruar deshmi librezen me targa 04-549-JT I cili ka pasur regjistrim valid deri me **19.06.2024.**

Pika 5 - Kjo pasije eshte ne pronsi te NNT BURIMI dhe ne Kohen kur eshte dorzu dosja e tenderit ka pasur dhe ka Validitet te regjistrimit deri me date 19.06.2024.

Pika 6. Kamion kipper me Kran cope 1 . OE ka ofruar dëshmi librezën e qarkullimit ne pronësi te BAGERI COMPANY me targa 05-795-FL e cila nuk është ne pronësi te OE ,dhe nuk ka ofruar deshmi dokumentare mbi marrjen me qera.

<u>Pika 6</u> - Marrveshjen per kete Paisje Kamion me Kran 05-795-FL e kemi me BAGERI - 1 dhe JO BAGERI COPMANY , ndersa ne FOLDERIN 12 gjenden deshmij Liberza

me validitet , foto dhe Marrveshja me BAGERI-1.

Pika 7. Lidhur me kerkesen nr7 ,Cilinder per ngjeshje te zhavorit minimum 12 t cope 1. OE ka ofruar nje fatur te dates 27.05.2022 me titull vibrator qe montohet ne eskavator I perdorur ne blere nga NSH SHALA ne vlere prej 200.00€.

Pika 7. Kjo paisje e lartecekur nuk ka ate beje me kerkesen e FDT-s te kerkuar nga AK ,CILINDER NGJESHES TE ZHAVORIT MIN 12t COPE 1. Paisja qe I plotsojn kriteret gjendet ne FOLDERIN NR 9 pika 8 VALAK (ngjeshes) Tip Lutong LT 214, Fatur , DUD e blere nga ARD COM.

Pika 8. Lidhur me kerkesen nr.8 ,Cilinder per ngjeshje te zhavorit me dhembeza cope 1, OE nuk ka ofruar deshmi dokumentare.

Pika 8. Paisja në fjale Cilinder me dhembeza gjendet ne FOLDERIN NR 9 , Marka Bomag tipi W213 BVC, si deshmi është DUD në emer të NNT BURIMI bashkangjitur dhe foto.

Pika 9. Lidhur me kerkesen nr.9, Instrument gjeodezik GPS për matje dhe rilevim të terenit copë 1, OE ka ofruar deshmi marrveshjen te marrjes me qera me OE NSH GEO&METRI ku qiradhenesi eshte Luan Abazi i cili njekohsishtë në këtë dosje te tenderit është prezantuar so Gjeodet i kontraktuar në cilësi të puntorit Gjeodet.

Pika 9 - Marrveshja për paisjen INSTRUMENT GJEODEZIK GPS e lidhur në mes të NNT BURIMI DHE GEO & METRI, ku pronar i kësaj Kompanie është Luan Abazi i cili është prezantu edhe si gjeodet në kompanin në fjalë , andaj mendojm se nuk bene ndonje shkelje të LPP.

Provë: Të dhënat e shkëputura nga ARBK për subjektin Agim Morina B.I.

Agim Morina B.I.

Emri i biznesit	Agim Morina B.I.
Emri tregtar	N.N.T.„Burimi"
Lloji biznesit	Biznes individual
Numri unik identifikues	810703571
Numri i biznesit	80140207
Numri fiskal	600074562
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	3
Data e regjistrimit	12/07/2000
Komuna	Malishevë
Adresa	Malishevë, , Imer Krasniqi
Telefoni	///
E-mail	///
Kapitali	€
Statusi në ARBK	Regjistruar
Statusi në ATK	///

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Nuredin	Morina	Përgjegjës i firmës.	

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Agim Morina	€	%

Njësitë

Nr	Numri i njëseisë	Emri	Vendi
1	5184401	N.N.T. Burimi	Malishevë, Panorc

Aktivitet/et

<u>Provë: Të dhënat e shkëputura nga ARBK për subjektin BURIMI AAF SH.P.K.</u>

BURIMI AAF SH.P.K.

Emri i biznesit	BURIMI AAF SH.P.K.
Emri tregtar	///
Lloji biznesit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Numri unik identifikues	811918385
Numri i biznesit	///
Numri fiskal	///
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	1
Data e regjistrimit	04/04/2022
Komuna	Malishevë
Adresa	Malishevë, Gj.K.-Skenderbeu, pn
Telefoni	+38345344447
E-mail	festim2.morina@universitetiaab.com
Kapitali	1,000.00€
Statusi në ARBK	Regjistruar
Statusi në ATK	///

Perfaqësues i autorizuar

Emri	Mbiemri	Pozita në biznes	Autorizimet
Alban	Morina	Drejtor menaxhues	Sipas ligjit dhe statutit.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri	Kapitali në €	Kapitali në %
Alban Morina	1,000.00€	100.00%

Njësitë

Nr	Numri i njëseisë	Emri	Vendi

Aktivitet/et

Kodi	Përshkrimi	Tipi

Prandaj në mbështetje te asaj qe u përshkrua si më lartë sqarimeve dhe provave të bashkangjitura ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, ndërsa propozoj qe njoftimi i datës 27.09.2023, të mbete në fuqi dhe AK të vazhdoj tutje.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" CAMI KOM " SH.P.K.**

Majlinda Bedrolli